



K.DH.SH.II.nr.998/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Saranda Bogaj Sheremeti, kryetare e kolegjit, Faton Bajrami dhe Franciska Zhitija Ymeri, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit G..., me pronar F.Z me seli në Fushë Kosovë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit avokat Irfan Zushi nga Vushtria, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: ndëshkim administrativ, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.1204/20 të datës 04.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr. 1204/20 të datës 04.11.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr. 1204/20 të datës 04.11.2021, është aprovuar kërkesëpadia e paditësit G.... me pronar F.Z me seli në Fushë Kosovë dhe është anuluar vendimi nr.135/2020 i datës 15.06.2020 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rivendosje dhe rishqyrtim.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë e paditura Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës administrative, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që ankesa e Administratës Tatimore të Kosovës të aprovohet në tërësi si e bazuar, dhe aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë të anulohet dhe të mbetet në fuqi vendimi kontestues i ATK-së apo çështja të kthehet në gjykatën e shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 49 të LKA, nenit 81.H të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat

nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e kundërshtuar nr.135/2020 datës 15.06.2020 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e paditësit, dhe është vërtetuar si i bazuar Vendimi i Zgjona-s nr. i datës 19.03.2020 për ndëshkime në vlerë prej 1,000.00€

Paditësi i pakënaqur me aktvendimin e lartcekur të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 17.07.2020, me pretendim se i njëjti është i pa drejtë dhe i pa paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër aktvendimit nr.135/2020 datës 15.06.2020 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, si dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit aprovon si të bazuar, dhe ka anuluar vendimin nr.135/2020 datës 15.06.2020 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje. Me arsyetim si në aktgjykimin e ankimuar .

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e bazuar.

Ndërsa për shkelje esenciale të dispozitave procedurale, Dhoma e Shkallës së Dytë gjeti se gjykata e shkallës së parë ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të së paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, ka nxjerr prova të mjaftueshme, që do të thotë se gjatë vlerësimit nuk ka bërë shkelje të dispozitave LKA-së dhe LPK-së.

Sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë nuk ka vendosur drejtë lidhur me dorëzimin e dëshmisë dhe provave të dorëzuara në gjykatë sepse e paditura ka dorëzuar të gjitha provat e nevojshme të cilat i'a ka bashkangjitur përgjigjes në padi dhe të cilat prova mbështesin vendimin kontestues të Departamentit të Ankesave të ATK-së, si dhe pretendimit se e paditura gjatë vizitës te paditësi me datë 13.03.2020 ka vërtetuar gjendjen faktike në momentin e caktuar kohor dhe se paditësi nuk ka respektuar dispozitat ligjore në fuqi dhe për këtë është ndëshkuar dhe se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit dhe ka anuluar vendimin e të paditurës duke e kthyer lëndën në rishqyrtim dhe rivendosje në ATK, Dhoma e Shkallës

së Dytë vlerëson se pretendimet e tilla ankimore nuk janë të bazuara për arsye se Gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejt kur ka vlerësuar se e paditura gjegjësisht Departamenti i Ankesave të ATK-së në riprocedurë konform autorizimeve nga dispozitat e nenit 44 pika 44, 45 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2010 duhet të marrë dëshmi të reja nga inspektori tatimor, paditësi, palët e treta, rreth fakteve eventuale që nuk janë trajtuar në procedurën administrative të ankesave, të shqyrtoj raportin e shitjes, pretendimet e paditësit dhe në fund të nxjerr konkluzion të drejtë në kuptim të gjendjes faktike , për arsye se ashtu sic ka konstatuar gjykata në shkallë të parë se organi i paditur ATK-së, nuk ka vërtetuar në tërësi gjendjen faktike me rastin e vizitës tek paditësi, kur ka nxjerr konstatimin se dy personave nuk iu ka lëshuar kupon fiskal paditësi gjatë shitjes së produkteve dezinfektuese dhe se nga ana e gjykatës nuk mund të pranohet një vendim të tillë, si i drejt dhe ligjor, ku ndëshkimi administrativ i shqiptuar paditësit, bazohet në paragjykimet respektivisht pa u identifikuar dy personat të cilët kanë blerë mall, pa i pranuar kuponat fiskal, e që në rastin konkret nuk ka informata se inspektori tatimor i cili ka qenë në vendin e ngjarjes ka respektuar në tërësi ligjin, duke gjobitur edhe dy personat blerës për blerje të mallit pa iu lëshuar kupona fiskal, obligim ky që parashihet me dispozitën e nenit 53 paragrafi 7 të Ligjit nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat

Gjykata në shkallë të parë me të drejtë ka konstatuar se në rastin konkret me provat e siguruar nga inspektori tatimor, nuk ka prova të mjaftueshme që do të gjejnë mbështetje në dispozitën e nenit 53.6 të Ligjit 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, që parasheh: çdo person i cili nuk i lëshon klientit të vet kupon nga pajisja e fiskalizuar, do të detyrohet për një gjobë e përcaktuar në përputhje me dispozitat e paragrafit 2 të këtij neni.

Gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejtë se në këtë konflikt administrativ ekzistojnë të meta që e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar andaj edhe nga kjo bazë e ka pas të pamundur të vendos në mënyrë meritore ashtu që me të drejtë e ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ka anuluar aktvendimin e kontestuar dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje duke e detyruar të paditurën që të veprojnë sipas vërejtjeve të dhëna e të cilat janë të obligueshme për organin e paditur, duke u bazuar në nenin 65 të Ligjit për Konflikte Administrative.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditurës. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditurës, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se te njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka anuluar nr. datës 15.06.2020 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës, dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e të paditurës u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
K.DH.SH.II.nr.998/22, me datë 10.11.2022

Kryetare e kolegjit,
Saranda Bogaj Sheremeti